



URDHËR

Nr. 66, Datë 28.08, 2014

"Për transferimin e studimeve në vite të ndërmjetme, në Ciklin e Parë të Studimeve me kohë të plotë në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2014-2015"

Bazuar në Nenin 35 të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; në VKM Nr. 517 datë 01.08.2014, pika 1; germa c, pika 10; si dhe në Rregulloren Mësimore të Ciklit të parë të Studimeve Bachelor në Universitetin e Arteve, Kreun VI, Neni 24 :

URDHËROJ

1. UART shpall të hapur procedurën për aplikim për transferim studimesh në Universitetin e Arteve për vitin akademik 2014-2015.
2. Fillimin e procedurave për pranimin e transferimeve të studentëve në vite të ndërmjetme nga Akademi, Universitete, Konservatorë dhe Shkolla të tjera arti, brenda ose jashtë vendit.
3. Kreditet e fituara nga aplikanti të jenë jo më pak se 48 kredite në programin përkatës të studimit, në mënyrë që të ketë mundësi të transferojë studimet në Universitetin e Arteve.
4. Aplikimi për transferim studimesh në Universitetin e Arteve bëhet individualisht, pranë Degës Mësimore dhe Zhvillimit të Kurikulave në Universitetin e Arteve.
5. Data përfundimtare e pranimit të dokumentacionit për aplikim për transferim studimesh është 30.09.2014.
6. Aplikuesi duhet të paraqesë një kërkesë në Universitetin e Arteve pranë Degës Mësimore dhe të Zhvillimit të Kurikulave, sëbashku me dokumentacionin e nevojshëm, i cili duhet të përfshijë:
 - a) Formularin e Aplikimit për Transferim Studimesh (Formulari gjendet në Zyrën e Degës Mësimore dhe zhvillimit të Kurikulave);
 - b) Kërkesë me shkrim ku të specifikohet Programi i Studimit që kërkon të ndjekë në Universitetin e Arteve;



- c) Kartën e studentit ose çdo dokument tjetër ku të vërtetohet që ka statusin e studentit nga Institucioni Arsimit nga vjen;
 - d) Kontratën e lidhur në momentin e regjistrimit në institucionin arsimor nga vjen si dhe çregjistrimin e tij nga ky Universitet.
 - e) Vërtetim në lidhje me programin e studimit dhe kursin ku ka qenë i regjistruar;
 - f) Vitin Akademik në të cilin bën shkëputjen;
 - g) Listën e Lëndëve, krediteve dhe notave të fituara (Në formë zyrtare, me firmë dhe vulë nga Institucioni arsimor që i ka lëshuar);
 - h) Programet e lëndëve të zhvilluara sipas planeve mësimore, në formë zyrtare, me firmë dhe vulë nga Institucioni nga vjen;
 - i) Kopje e noterizuar e Diplomës së shkollës së mesme;
 - j) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë);
 - k) Për aplikantët jo shtetas Shqiptarë dëshmia e gjuhës shqipe. Kjo pikë nuk vlen për Shqiptarët e Trojeve;
 - l) Për institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit, dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë i përkthyer në shqip dhe i noterizuar në Shqipëri;
 - m) Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale, ose të noterizuara;
7. Dega Mësimore të verifikojë të gjithë dokumentacionin, sipas pikës 6 të këtij urdhri, dhe sëbashku me aplikantin, protokollon legjendën e dokumentacionit përmbledhës sipas renditjes së mësipërme dhe me numrin e faqeve të tyre për çdo nënpikë. Aplikantit i jepet një kopje e kësaj legjende sëbashku me numrin e protokollit.
 8. Dega mësimore ka përgjegjësinë të verifikojë legjitimitetin e institucionit të Arsimit të Lartë nga vjen studenti, nivelin e programit të studimit që ka ndjekur studenti, vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura. Kryetarja e Degës Mësimore dërgon propozimet në bazë të kërkesave pranë Zëvendës Rektorit të anës mësimore për procedurë të mëtejshme.
 9. Zëvendës Rektori i anës mësimore ndjek gjithë praktikën me MAS, për propozimin dhe miratimin e kuotave përkatëse.
 10. Me miratimin e kuotave, Dega Mësimore përcjell në fakultetet përkatëse të gjithë dokumentacionin e bashkëlidhur për çdo aplikant dhe ja dorëzon me protokoll Sekretarive mësimore.
 11. Dekani i fakultetit ngre komisionin e njohjes dhe ekuivalentimit të lëndëve, në të cilën duhet të marrin pjesë përfaqësues të grup lëndëve që do të ekuivalentohen.



12. Numri i anëtarëve të komisionit të jetë nga 3 deri me 5 veta.
13. Komisioni të bëjë ekuivalentimin e disiplinave që ka dhënë studenti me disiplinat tona përkatëse duke pasur parasysh kreditet e lëndës, programin e lëndës dhe notën e marrë. Komisioni në shqyrtim të dokumentacionit mund të bëjë:
 - a) Njohje të plotë të lëndës, nëse kreditet e fituara sipas sistemit ECTS janë jo më pak se kreditet e disiplinës përkatëse të programit të studimit dhe programet e lëndës kanë një përafërsi në mbi 75% të tyre.
 - b) Njohje të pjesshme të lëndës, kur kreditet e fituara sipas sistemit ECTS janë më pak se kreditet e disiplinës përkatëse të programit të studimit dhe/ose programet e lëndës kanë përafërsi jo më pak se 50%.
 - c) Mosnjohje të lëndës, kur kreditet e fituara janë më pak se 50% e krediteve të disiplinës përkatëse dhe/ose programi i lëndës nuk përputhet me programin e disiplinës.
14. Krahas njohjes së plotë të lëndës, komisioni të bëjë ekuivalentimin e notës së fituar sipas sistemit tonë të vlerësimit me 10 nota.
15. Në rastet e njohjes së pjesshme të lëndës, studentit i caktohet pjesa e programit që do të shlyhet, për të cilën mund të mos jetë domosdoshmëri frekuentimi i leksioneve dhe ushtrimeve, por frekuentimi i orëve speciale dhe praktikave është i detyrueshëm. Shlyerja mund të realizohet nëpërmjet provimit, bashkëbisedimit, projektit, ose forma të tjera që përcaktohen nga komisioni në funksion të natyrës së lëndës. Në vlerësimin përfundimtar merret parasysh edhe vlerësimi që ka marrë paraprakisht studenti për një pjesë të lëndës.
16. Në rastet kur komisioni bën njohje të plotë të programit të lëndës, por nuk bën dot ekuivalentimin e notës sipas sistemit tonë të vlerësimit, komisioni mund të marrë një vendim në lidhje me rivlerësimin e njohurive që ka fituar studenti në lëndën përkatëse. Forma e rivlerësimit përcaktohet nga komisioni në funksion të natyrës së lëndës.
17. Për të gjitha vlerësimet e bëra Komisioni i Vlerësimeve, të hartojë raportin përfundimtar të vlerësimit dhe me anë të një shkrese, të firmosur nga të gjithë anëtarët, ja dërgon Dekanit të fakultetit me të gjithë procedurën e kryer, kreditet, pikët e vendosura, dhe çdo dokument tjetër të nevojshëm për këtë proces.



18. Dekani i Fakultetit në funksion të numrit të krediteve të njohura përcakton vitin e ndërmjetëm ku do të regjistrohet studenti në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përcakton gjithashtu edhe kreditet debite (nëse janë të nevojshme) që duhet të plotësojë studenti në përputhje me programin e studimit ku është pranuar nga Komisioni i Vlerësimit.
19. Për të gjitha veprimet e kryera më sipër nga Komisioni i Vlerësimit, si dhe për formën e përshtatshmërisë ose të mos pranimit të aplikantit, Dekani duhet të informojë në Rektorat, Zv. Rektorin e anës mësimore.
20. Ngarkohet Zv. Rektori i anës mësimore për dërgimin listave të emrave fitues në MAS dhe në Agjencisë Kombëtare të Provimeve për gjenerimin e numrave të matrikullimit për transferimet e studimeve të ndërmjetme, për vitin akademik 2014-2015.
21. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, ZV/Rektori për anën mësimore, Dekanët e Fakulteteve dhe Kryetarja e Degës Mësimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Prof. Petrit MALAJ

REKTOR
UNIVERSITETI I ARTEVE